



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.01.2023

Nr: 06

Ora: 12:45

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 16 TË SUBJEKTIT ANKUES PARTIA “FRYMA E RE DEMOKRATIKE”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.01.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia “Fryma e Re Demokratike”

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 16, datë 19.12.2022 me objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mbi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021”.

BAZË LIGJORE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124/1, 133, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe shkronja “b”, pika 1, të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Rrethanat e çështjes:

1. Në përfundim të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, me vendimin nr. 224, datë 07.12.2022. Në vendimin e sipërcituar, ndër të tjera, në pikën 21 të tij Komisioneri vendosi :

Detyrimin e partisë politike “Fryma e Re Demokratike” të kthejë në KQZ shumën prej 485.332 (katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë, sipas nenit, 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor;

2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore partia politike “Fryma e Re Demokratike”. Në ankim subjekti ankues pretendon se diferenca prej 485.332 lekësh është paguar/shpenzuar nga Partia “Fryma e Re Demokratike” përtej afatit kohor të përcaktuar si “Fushatë Zgjedhore” sipas legjislacionit në fuqi, por pagesat e kryera edhe pse në periudhë të konsideruar si jo fushatë zgjedhore, i përkasin shpenzimeve të kryera për vazhdimësinë e saj. Sipas tyre, ky rast nuk mund të përfshihet si rast i pikës 7 të nenit 88 të Kodit Zgjedhor. Për këtë arsye, kërkojnë shfuqizimin e masës administrative të vendosur dhe rishikimin e vendimit.
3. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvin Lako. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 23.01.2023, ora 12:45.
4. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.224, datë 07.12.2022;
- Kërkesën ankimore nr. 16, datë 19.12.2022;
- Kontratën e qirasë të lidhur midis z. Arben Kasmi dhe z. Sali Shehu më 01.06.2022;
- Shkresën nr. 02 prot. datë 30.03.2022 drejtuar KQZ për pasqyrat financiare të partisë politike FRD për vitin 2021.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

Një nga pjesët më të rëndësishme të një procesi demokratik zgjedhësh është fushata zgjedhore. Fushatat janë mënyrat e partive politike dhe kandidatëve të tyre për të fituar mbështetjen e votuesve në periudhën para zgjedhjeve. Subjektet zgjedhore përdorin një sërë teknikash për të arritur te votuesit, si daljet publike, mitingjet, përdorimi i reklamave në media etj. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.

Subjektet zgjedhore përfitojnë financime publike dhe jopublike në mbështetje të fushatës së tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse. Gjatë fushatës zgjedhore ata kanë një sërë të drejtash dhe detyrimesh të cilat renditen në mënyrë deklarative në nenin 78 të Kodit Zgjedhor. Ndër të tjera, subjektet zgjedhore bartin detyrimin për transparencë dhe publikim të të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt KQZ-së, personave të ngarkuar me auditimin apo monitorimin dhe publikut.

Neni 88 i Kodit Zgjedhor parashikon se partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, janë një nga burimet e financimit të fushatës zgjedhore. Partia politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe KQZ-ja, para shpërndarjes së fondit, nënshkruajnë aktmarrëveshje, në të cilën përcaktohet se partia politike pranon fondin e dhënë, se do ta përdorë atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, pranon monitorimin e shpenzimit të tyre prej subjektit dhe kandidatëve të tij, si dhe do të respektojë të gjitha ndalimet që përcaktohen në këtë ligj për ta.

Në vendimin nr. 224/2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve rezulton se subjekti zgjedhor Partia Fryma e Re Demokratike ka patur shpenzime për qëllim të fushatës zgjedhore në total 1.703.500 lekë. Me vendimin nr. 172, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ky subjekt ka përfituar fonde nga Buxheti i Shtetit 2.188.832 lekë. Pra, është një diferencë prej 485.332 lekësh të cilat nuk janë deklaruar/raportuar nga ky subjekt si shpenzim për fushatën zgjedhore.

Në seancën e datës 23.02.2023, përfaqësuesi i subjektit ankues u shpreh se nuk kishte kontestime lidhur me diferencën e shumës së përfituar nga Buxheti i Shtetit dhe shumës së shpenzuar gjatë fushatës zgjedhore. Ai ngriti pretendimin se me shumën e mbetur janë kryer disa shpenzime në vazhdimësi të fushatës zgjedhore, duke paraqitur në seancë një kontratë për marrje me qera të ambienteve zyra për ushtrimin e aktiviteteve të partisë si dhe pasqyrat financiare të partisë për viti 2021.

Pika 7 e nenit 88 të Kodit Zgjedhor parashikon se *“Në rast se shuma e përlllogaritur në pikën 5 të këtij neni është më e lartë se totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të raportuara nga partia politike ose është vlerësuar si e tillë nga KQZ-ja sipas auditimeve të pavarura apo verifikimeve të saj, atëherë partia politike është e detyruar të kthejë diferencën në KQZ”*.

Duke marrë parasysh faktin se shpenzimet e kryera nga partia politike nuk janë kryer gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, por në një kohë të mëvonshme, bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar, ky subjekt detyrohet të kthejë diferencën në KQZ.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja ‘b’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe shkronja “b”, pika 1, të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 16, datë 19.12.2022 të partisë politike “Fryma e Re Demokratike”;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mbi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021”;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**